



# KLINIKA REFERENTE

është klinika e mjekësisë familjare,  
e përforcuar me motrën medicinale  
(infirmieren) të diplomuar.



Kartela personale

Mjeku: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit të klinikës së mjekut: \_\_\_\_\_

Motra medicinale e diplomuar për klinikën

referente: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit të motrës medicinale të diplomuar: \_\_\_\_\_

Instituti Kombëtar për shëndetin publik, Qendra e menaxhimit të programeve për promovimin e shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve.  
[www.nijz.si](http://www.nijz.si) in [www.skupajzdravje.si](http://www.skupajzdravje.si).

»Ky dokument u krijua me mbështetjen financiare të mekanizmit financiar Norvegjez. Përgjegjës për përmbajtjen e këtij dokumenti është vetëm NIJZ dhe ai në asnjë rrethanë nuk duhet të reflektojë pozicionin e Bartësit të Programit të mekanizmit financiar Norvegjez.«

Informata më të hollësishme mbi programin e Mekanizmit Financiar Norvegjez gjeni në faqen e internetit [www.norwaygrants.si](http://www.norwaygrants.si) dhe në faqen kryesore të internetit të Mekanizmit Financiar Norvegjez [www.norway-grants.org](http://www.norway-grants.org). Faqja e internetit e bartësit të programit është [www.svrk.gov.si](http://www.svrk.gov.si).

## PËRMBAJTJA E SHQYRTIMIT

- Bisedë në lidhje me programet preventive (ZORA, DORA, SVIT);
- rekomandimi për marrjen e gjakut, ku konstatohet rrezikimi për sëmundjen e sheqerit (diabetit) dhe yndyrërat në gjak;
- peshimi dhe matja e gjatësisë trupore dhe perimetrit/vëllimit (trashësisë) të pacientit, ku konstatohet gjendja e të ushqyerit;
- matja e tensionit (shtypjes) së gjakut dhe inçizimi EKG/EKO-s, ku konstatohet punimi i zemrës;
- konstatimi i kapacitetit të mushkërive (matja e nivelit të oksigjenit dhe testi i spirometrisë);
- Bisedë në lidhje me stilin e jetesës së pacientit, mënyrën e të ushqyerit dhe aktivitetit fizik (konsultë dhe ndihmë për edukim fizik);
- pacientit me diagnozë të caktuar (sëmundje sheqeri / diabet, tension të lartë gjaku, astëm, KOPB, osteoporozë, prostata, depresion) i bëjmë të gjitha analizat / matjet, që kanë të bëjnë me protokollin e sëmundjes së diagnostikuar;
- nxjerrim në pah faktorët rrezikues dhe në lidhje me ta diskutojmë me pacientin;
- në rast se konsatohen simptoma të mundshme të një sëmundjeje apo sëmundjeje në progresion, pacientët i drejtojmë për tek mjeku personal, i cili vazhdon me trajtimin e tij (mjekimin e sëmundjes);
- pacientit me sëmundje të diagnostikuar i konstatohet rregullimi dhe përqësimi eventual i sëmundjes.

## QËLLIMI I KONTROLLIT / VIZITËS

- sigurimi i shqyrtimit akoma më cilësor të pacientëve,
  - parandalimi i avancimit / progresionit të sëmundjeve kronike,
- sigurimi i një mbikëqyrje më të mirë mbi sëmundjen kronike të avancuar.

## KLINIKA REFERENTE

Të gjithë pacientët, që kanë të zgjedhur mjekun e familjes / personal zakonisht i bëjnë vizitat preventive tek mjeku tyre i zgjedhur. Të gjithë vizitat mjekësore preventive që prej vitit 2011 i ka marrë përsipër motra medicinale e diplomuar në kuadër të projektit të klinikave referente. Në kontroll / vizitë preventive do të ftohen të gjithë si pacientët e rritur nga mosha 30 vjeç e sipër, të cilët janë ende të shëndetshëm, ashtu edhe ata të cilët kanë sëmundje kronike të caktuara dhe trajtohen me ilaçe/barna.

## (INFERMJERJA) MOTRA MEDICINALE E DIPLOMUAR KRYEN

- konsulta në lidhje me mënyrën e shëndetshme të jetesës,
- zbulimin e hershëm të faktorëve rrezikues për avancimin e sëmundjeve kronike,
- drejtimin/menaxhimin e pacientëve me sëmundje kronike të diagnostikuara.

